



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 639/1 prot.

Tiranë, më 20. 05. 2024

V E N D I M

Nr. 143, datë 20. 05. 2024

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 90 Regj., datë 26.04.2024, të shtetasit L. P., kundër Shoqërisë Posta Shqiptare sh.a., në të cilën pretendohet për diskriminim për “çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Bazuar në parashtrimet si dhe dokumentacionin e përcjellë pranë KMD-së nga subjekti ankues, parashtrohet ndër të tjera se: *“Unë ankuesi L. P. jam detyruar që t’ju drejtohem ju me këtë ankim, pasi e ndiej veten të diskriminuar nga punëdhënësi im, Shoqëria Posta Shqiptare Sh.a Tiranë, në të drejtën time të punësimit.*

Fillimisht, unë si shumë shqiptarë të tjerë të dalë nga një sistem “monist”, dhe për një jetë më të mirë, e për t’u punësuar, kam emigruar në shtetin Grek si emigrant ekonomik, në muajin mars të vitit 1993, ku kam qendruar për një periudhë prej 8 vitesh.

Më pas kam ardhur në Shqipëri dhe jam vendosur në qytetin tim të lindjes, qytetin Burrel, Njësia Administrative Burrel, Bashkia Mat.

Pasi jam martuar, me qëllimin e mirë të arsimimit tim, si një endërr e imja dhe e çdo individi, kam përfunduar studimet e nivelit të lartë arsimor “Fakultetin Ekonomik”, dhe më pas dhe studimet në degën “Fakulteti Juridik”, si dhe pas kam ndjekur dhe shkollën e avokatisë, ku kam dhe liçencën me nr. 10351 si “Avokat”, dhe kurse të tjera trajnimi.

Kam aplikuar për t’u sistemuar në punë, dhe më datë 16.11.2013, jam emëruar si Drejtor i Zyrës së Punësimit Mat, detyrë të cilën e kam kryer deri me dt. 19.08.2022, kur jam emëruar Drejtor pranë Filialit të Postës Mat, me Urdhrin nr. 266, dt. 18.08.2022 të Administratorit të Postës Sh.a. Tiranë.

¹ Në vijim do t’i referohemi me akronimin: KMD.

Në këtë detyrë jam emëruar, pasi në këtë institucion e konkretisht Filialin e Postës Mat, kishin ndodhur vjedhje në vlera të mëdha, e me qëllim përmirësimin e punës në këtë institucion, jam emëruar dhe kam vijuar të punoj duke patur si parësorë, respektimin e ligjit, kthimin e shërbimit me ligj e në respektim të të drejtave të çdo individit dhe institucioni që kishte lidhje pune me shoqërinë tonë si Filial i Postës Mat, duke nxjerë urdhërat dhe udhëzimet përkatëse për normimin e funksionimin e punës në këtë filial, dhe mendoj se ja kemi arritur duke punuar të gjithë në grup e duke respektuar ligjin, pasi vetëm atëherë puna shkon mirë ashtu sikurse shkoj përgjatë kohës që unë punova dhe drejtova.

Për shkak të funksionit tim si Drejtor, i jam nënshtruar procesit të aplikimit dhe plotësimit të dokumentacionit të kërkuar për pajisjen me “Certifikatën e sigurisë së personelit (CSP)”, sipas Urdhërit nr. 26, dt. 31.01.2022 të Drejtorisë së Përgjithshme të Postës Sh.a, ndonëse ligji, nuk e kërkon një gjë të tillë.

Në këtë dokumentacion të plotësuar nga ana ime, është pasqyruar në mënyrë korrekte dhe të detajuar i gjithë informacioni i kërkuar sipas modelit të miratuar nga AKSIK si dhe kam nënshkruar Deklaratën për dhënien e pëlqimit për mbledhjen e të dhënave rreth personit tim, dhe Deklaratën për ruajtjen e informacionit të klasifikuar.

Autoriteti i AKSIK, ka patur detyrimin ligjor që pajisjen, refuzimin, apo pezullimin e CSP-së, ta përfundonte për një periudhë prej 120 ditësh, referuar ligjit 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”.

Me dt. 27.01.2024 jam vënë në dijeni me shkresën nr. 109/1 prot., dt. 26.01.2024, të Administratorit të Postës Shqiptare Sh.a. në lidhje me vendimarrjen e marrë nga ana e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar me të cilën mua më është refuzuar pajisja me “Certifikatën e sigurisë së personelit (CSP)”.

Unë sapo kam ardhur në dijeni të kësaj vendimmarrje refuzimi për certifikimin tim, duke mos qenë absolutisht dakort, kam ushtruar ankimin administrativ, pranë Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, dhe pranë Administratorit të Shoqërisë Posta Shqiptare Sh.a Tiranë, me datë 29.01.2024, ku kam kërkuar arsyen ligjore në lidhje me mos-certifikimin tim dhe vënien në dispozicion të dokumentacionit mbi të cilin është marrë kjo vendimmarrje, pasi ato kanë të bëjnë me personin tim dhe AKSIK ka detyrimin ligjor të më vinte në dijeni të paktën në mënyrë të përmbledhur, duke ruajtur të dhënat personale, se kush janë arsyet ligjore dhe shkaku i marrjes së kësaj vendimmarrje, pasi unë nuk kam pse kurrsesi të hesht përballë kësaj padrejtësie dhe ky autoritet nuk më ka vënë në dispozicion dhe as nuk më ka bërë me dije arsyen dhe dokumentacionin mbi të cilin është marrë ky vendim refuzimi, por as nuk më ka thyer një përgjigje negative të paktën për ankesën time.

Në respektim të ligjit 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”, dhe konkretisht nenit 30, kriteret që duhet të plotësohen për t’u pajisur me CSP janë të normuara qartë, si dhe institucionet ku kërkohet informacion në lidhje me veprimtarinë time dhe të personit tim...

Njëherazi normimi i këtyre kriterëve gjen zbatim dhe në VKM nr. 188 dt. 04.03.2015 “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit”, konkretisht në nenin 10, 12, 13, 14, si dhe në nenin 2 pika 3, ku është treguar se kush janë institucionet të cilat mund të japin informacione.

Unë kam qenë emigrant ekonomik në shtetin grek, dhe për arsyet e mia kam ndryshuar emrin dhe mbiemrin tim nga F. P. në L. J. (P.), në rrugë të ligjshme me vendim të Këshillit Bashkiak Mat me dt. 09.10.1996, pasi për të qendruar dhe punuar në shtetin grek në ato vite terrori për ne emigrantët shqiptar, nevojitej më mirë një emër grek se emër turk si ai i imi.

Kam qendruar në këtë shtet për rreth 8 vite. Kam ardhur në Shqipëri në fund të vitit 2000, dhe jam martuar me shtetasen S. (H.) P. Bashkëshortja ime ushtron profesionin e avokatit. Kam 2 fëmijë të cilët sot janë madhorë.

Për vitin 2011-2013 kam punuar pranë zyrës së avokatit me seli në qytetin Burrel.

Me dt. 16.11.2013 jam emëruar si Drejtor i Zyrës së Punësimit Mat, detyrë të cilën e kam kryer deri me dt. 19.08.2022, kur jam emëruar Drejtor pranë Filialit të Postës Mat, me Urdhërin nr. 266, dt. 18.08.2022 të Administratonit të Postës Sh.a. Tiranë.

Për gjatë gjithë jetës time nuk kam patur kurrë problemin më të vogël ligjor, kurrë penal, por asnjë problematikë dhe të vogël civile.

Ndaj meje nuk është marrë kurrë asnjë masë as e karakterit penal dhe as e karakterit civil dhe as nuk jam shoqëruar qoftë dhe një herë pranë organeve ligj-zbatuese.

Në respektim të nenit 30 të ligjit 10/2023 është treguar se kush janë kriteret që duhet të plotësojë për t'u pajisur me CSP.

Nëse AKSIK ka marrë vendimin e refuzimit mbi letra anonime, unë do t'i drejtohem dhe prokurorisë kompetente në lidhje me këtë problematikë për tu hetuar, pasi nuk mund të përbaltem me anonimate dhe me të pavërteta, pasi puna dhe jeta e çdokujt, është e kontrollueshme dhe e verifikueshme, njëkohësisht dhe për personin tim.

Nuk jam absolutisht dakord me këtë vendim dhe me arsyetimin e tyre, pasi dua të sqaroj KMD, se unë nuk kam asnjë problematikë në lidhje me ligjin, si dhe nuk kam qenë asnjëherë dhe i shoqëruar në organet ligj-zbatuese e as të kem patur më të voglin problem në komunitet.

Unë i jam drejtuar administrativisht organit kompetent që ka marrë vendimin e refuzimit, por deri në ditën e sotme unë nuk kam asnjë përgjigje.

Referuar VKM-së nr. 188, datë 04.03.2015 "Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit", neni 27 i tij, tregohen rastet e refuzimit dhe pezullimit të përkohshëm të CSP-së.

Në këto raste kjo i bëhet me dije titullarit të strukturës kërkuese (ku në rastin tim është Administratori i Postës Shqiptare Sh.a Tiranë), i cili referuar nenit 27/2 të kësaj VKM-je, ka të drejtë të bëjë kërkesë me shkrim për rishqyrtimin e vendimit të marrë nga AKSIK. Kjo kërkesë i adresohet titullarit të AKSIK brenda 15 ditëve nga data e marrjes së njoftimit të vendimit të refuzimit të CSP. Titullari i AKSIK shqyrton dhe vendos për kërkesën brenda 30 ditëve. Në rastet e mospajtit me përgjigjen e AKSIK brenda 15 ditëve nga data e marrjes së njoftimit, titullari i strukturës kërkuese, i drejtohet me Ankesë me shkrim Kryeministrit, i cili nga ana e tij brenda 30 ditëve shprehet me akt të veçantë, akt i cili është i përfundimtar.

Ju lutem kërkoj nga ana Juaj që për këtë të pyetet Administratori im përse nuk e ka ezauruar këtë kërkim, kam qenë punonjësi i tij, nuk kam patur kurrë shkelje, kam kryer detyrën me shumë korrektesë e ndershmëri, dhe Administratori im e di shumë mirë një gjë të tillë, por ato kanë nisur procedurën dhe më kanë larguar na detyra.

Nëse administritori im do të kishte ezauruar këtë kërkim (mjet ligjore që i njeh ligji atij), do të kishte ardhur si ai, si unë në dijeni për arsyen, pasi ndoshta lidhet me ndryshimin tim të emrit, dhe kjo nuk përbënte shkak të largohesha nga detyra dhe të fytesha e të denigrohej figura ime në këtë mënyrë.

Jo pa qëllim ligjvënësi ja ka lënë Administratorit të Shoqërisë këtë legjitimitet që vetëm ai mundet të kërkonte arsyen dhe të ankimonte atë akt, dhe jam shqetësuar e fyer pa masë se përse Administratori im nuk e ka kërkuar një gjë të tillë, pasi sikurse tregova më lart ai e di mjaft mirë korrektesën time në punë dhe përkushtimin në kryerjen e detyrës, pasi unë nuk kam përgjatë gjithë jetës time në detyrë qoftë dhe një këshillim.

Kjo sjellje më ka fyer rëndë, pra dhe largimi im nga detyra në këtë mënyrë jo vetëm më ka fyer, por ka ndikuar në figurën time dhe në personalitetin tim, pasi komuniteti ku ne jetojmë është i vogël, por jo vetëm tanimë nuk mund të adresoj dhe një kërkesë të re për punësim, pa sqaruar këtë situatë.

Ju lutem, nuk di se si mundet të ndërpritet marrëdhënia e punës, ndërkohë që as ligji nuk e kërkon që Drejtori i Filialit të pajiset me CSP, dhe vetëm një Urdhër i Administratorit e ka normuar dhe e kërkon, (dhe Administratori nga ana e tij hesht dhe nuk ushtron mjetet ligjore në lidhje me sa më sipër, ankimin administrativ). Si duhet ta lexoj unë këtë situatë, ndërkohë që unë nuk kisha asnjë akses në dokumenta sekrete, pasi vetë posta nuk prodhon dokumenta sekrete apo konfidenciale, pasi punonjësit e emëruar sipas ligjit thjeshtë merren me përpunimin dhe shpërndarjen e pakove postare të klasifikuara dhe i adresojnë atje ku duhet, dhe ajo është detyrë e tyre dhe jo e imja e e askujt në atë institucion, por e vërteta qendron diku larg.

I Nderuari zoti Komisioner!

Unë nuk do të kisha asnjë problem të isha larguar nga detyra për shkelje, mosrealizim detyrash, por nuk do të ndodhte kurrë me personin tim, sepse nuk kam marrë kurrë dhe një lek dieta, dhe shërbime, por i kam hequr nga rroga e fëmijëve të mi. Nën drejtimin tim të këtij Filiali, kemi ulur shpenzimet dhe kemi rritur të ardhurat e institucionit, duke punuar me përkushtim e korrektesë, duke i kursyer kësaj shoqërie dhe një lek. Kam qendruar pranë çdo individ, me të vetmin qëllim që të mos ndodhnin situata të rënda (sikurse kishin ndodhur vjedhje e abuzime të njëpasnjëshme) dhe të dëmtoheshin pensionistë e individë në nevojë të cilëve ne ju shërbejmë duke ju shpërndarë pensione, ndihma, etj.

Nuk qenka e thënë të jesh korrekt, të punosh me nder, të zbatosh ligjin e të ecësh, dhe tani duhet të bëjmë luftë me vetveten, se si të sillemi, por ju them me bindje se sa të jem gjallë kurrë nuk do të shkel ligjin, sepse vetëm atëherë je shumë qetë shpirtërisht por dhe ligjërisht. E vërteta dhe e drejta vonon por nuk harron.

Një muaj pas largimit tim, Qeveria Shqiptare ka larguar nga detyra dhe Drejtorin e AKSIK, kam dëgjuar që dhe ai është larguar pa motivacion, pa i bërë me dije se përse, nuk di se si është ndjerë ai në këtë situatë, por zoti është i mdh, ka nënshkruar e ka përgatitur një refuzim pa e merituar ka pajisur me CSP individ problematikë, dhe ka refuzuar pa të drejtë individ korrektë, arsyeja është tek ato. Dhe nëse drejtësia nuk do të dalë kurrë, ka dhe drejtësi zoti...

Jam shumë i shqetësuar, është krijuar ndaj meje me pa të drejtë një cenim i dinjitetit tim, është krijuar një mjedis përçmues, poshtërues ndaj meje me pa të drejtë.

Ama është e çuditshme, se as nuk më bëhet me dije as në mënyrë të përmbledhur se përse ka ndodhur, që dhe unë të mbaj qëndrimin tim. Unë e konsideroj një formë të rëndë diskriminimi, që të thirrem për të kryer procedurën dhe të më thuhet se nuk je pajisur me CSP dhe do të largohesh nga detyra, pa e ditur arsyen se përse.

Referuar nenit 7/1 të ligjit tregohet se çdo veprim ose mosveprim i autoritetit publik, që krijojnë baza dhe ekzpozim ndaj një trajtimi të padrejtë, përbën diskriminim. Në rastin tim mendoj se mosveprimi i Administratorit (mos ezaurimi i kërkesës administrative pranë AKSIK), kanë sjellë më tej procedurën e paligjshme dhe diskriminim tim. Pse është refuzuar, çfarë kam shkelur dhe pse duhet të largohem nga detyra, pasi nuk kam shkelur asnjë dispozitë të Kontratës Individuale të punës që kam nënshkruar me punëdhënësin tim, nuk kam shkelje as të lehta në mënyrë të përsëritur e as të rënda që të ndodhë largimi nga detyra.

Referuar VKM-së nr. 502, datë 23.06.2010 “Për Miratimin e rregullores për transportin fizik të Informacionit të klasifikuar “Sekret Shtetëror” tregohen subjektet dhe përkufizimet se kush janë punonjësit “Korrieri i postës së klasifikuar Sekret Shtetëror” dhe “Punonjësi i Postës së Klasifikuar “Sekret Shtetëror” (Përpunuesi), dhe kjo rregullore ka të normuar qartë personat që merren me përpunimin e pakove postare sekrete, dhe transportit të tyre fizik, dhe nuk ka lidhje as Drejtori dhe asnjë punonjës i institucionit. Dhe këta punonjës duhet të jenë pa filluar detyrën të pajisur me “certifikatë sigurie”, e normuar kjo në kreun III “Rregulla të përgjithshme”, pika 5, të VKM-së.

Në rastin konkret, unë si titullar i institucionit kam bërë kërkesë për pajisje me CSP, në muajin Shtator 2022, dhe përgjigja ka ardhur nga AKSIK në Janar të vitit 2024. Si ka mundësi që ka vonuar kaq gjatë, si ka mundësi që unë kam punuar pa këtë dokument për gjatë një vit e gjysëm pune, kush duhet të mbajë përgjegjësi atëherë, meqenëse sipas Administratorit të Shoqërisë duhet të kisha CSP, dhe meqenëse sipas tyre kam akses në informacionin e klasifikuar. Dhe vetë AKSIK ka detyrim ligjor që brenda 120 ditëve të kthej përgjigjen për pajisjen ose jo, me CSP (Certifikatë Sigurie).

I nderuari z. Komisioner!

Me shkresën nr. 109/2 prot., dt. 29.02.2024, të Administratorit të Postës Shqiptare Sh.a, ndër të tjera më është bërë me dije se më dt. 04.03.2024, do të bëhet takimi për zgjidhjen e marrëdhënies së punës.

Me dt. 04.03.2024 jam paraqitur në takim ku kam ngritur të gjithë pretendimet e parashtuara më sipër, të cilat nuk janë marrë asnjëra në konsideratë dhe me Urdhrin me nr. 61, dt. 07.03.2024 të Administratorit është urdhëruar “Zgjidhja e Kontratës Individuale të punës”.

Në rastin tim, procedura e largimit nga detyra, formalisht është ezauruar, por sot mendoj se veprimet kanë qenë të paramenduara dhe të qëllimshme, pasi në asnjë dispozitë të K.Punës, as në Kontratën Individuale të datës 22.08.2022, pika 11 e saj, nuk gjen mbështetje ky motivacion, por dhe në rastin tim unë nuk e di arsyen se përse është refuzuar dhe përse jam larguar nga detyra, dhe nuk di se përse Administratori nuk ka ezauruar nenin 27/2 të VKM nr. 188, datë 04.03.2015 “Për miratimin e Rregullave për sigurimin e personelit”

Jam dënuar pa gjyq, ama kjo sot në vitin 2024 nuk duhet të ndodhë.

Unë ankuesi L. P., dua të them se veprimet dhe aktet janë diskriminuese dhe nuk përlligjin motivin e largimit tim nga detyra dhe kjo në kundërshtim me nenin 9 të Kodit të Punës...

Shoqëria Posta Shqiptare Sh.a, mund ta zgjidhte kontratën e punës në mënyrë të menjëhershme, pasi të kishte kërkuar informacion se çfarë fshihet rreth personit tim, dhe përse është ky refuzim, pasi kam qenë punonjës i tyre dhe ata e dinë se çfarë unë përfaqësoj, dhe jo pa qëllim ky akt kërkohej çdo një vit.

Unë si të gjithë shtetasit Shqiptarë gëzoj mbrojtje. Në bazë të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, unë kam të drejtë të dëgjohem dhe të mbrohem, pasi të gjithë janë të barabartë përpara ligjit..., e në rastin konkret nuk ka ndodhur, pra jam dënuar pa gjyq, pa ditur arsyen pse refuzohet pajisja me CSP, dhe as Administratori që kishte detyrë ankimin nuk e ka kërkuar.

E gjithë procedura ligjore, tregon se jam trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pabarabartë... Unë jam diskriminuar duke ju refruar dhe nenit, 2 dhe 3 të ligjit, unë duhet të trajtohem në mënyrë të drejtë dhe në rastin tim nuk ka ndodhur një trajtim i tillë nga punëdhënësi pasi unë jam larguar për arsye që nuk dihen dhe nuk më janë bërë me dije, dhe punëdhënësi im nuk ka ndërmarrë asnjë hap që të kërkojë një informacion se përse dhe për çfarëdo arsye tjetër, që ju si Komisioner e çmoni...

Jam i shqetësuar pa masë, nuk di se ku të shkojmë e të kërkojmë të drejtën, pasi jo vetëm e drejta e punës po nëpërkëmbet, por dhe e drejta për të jetuar po na vështirësohet se nuk di se ku të shkojmë, po cenohemi në personalitet e në dinjitet, po na bëjnë jo të largohemi nga Shqipëria por të vëmë në dyshim a duhet të jetojmë, duke na vënë të pavërteta, duke na vrarë e na lënë gjallë.”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës së tij, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri, konstatimin e diskriminimit nga ana e Shoqërisë Posta Shqiptare sh.a.

- Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, ankuesi është kontaktuar nga Komisioneri nëpërmjet e-mailit, me datë 13.05.2024 dhe i është kërkuar të plotësojë kriteret formale të ankesës, duke depozituar prova dhe fakte lidhur me shkakun e diskriminimit të pretenduar “*çdo shkak tjetër*”, në mënyrë që të evidentohet se cila është karakteristika e veçantë që mbart dhe që prezumohet se ka ndikuar në kryerjen e sjelljes diskriminuese të pretenduar.

Në përgjigje të kërkesës të mësipërme, ankuesi përmes e-mail-it datë 15.05.2024, ka sqaruar ndër të tjera se: “*Kam filluar punë pranë Filialit të Postës Mat pas problematikave të theksuara abuzive në këtë Filial, në lidhje me funksionimin e punës në të gjithë Filialin.*

Fillimisht pasi kam hulumtuar rreth problematikave në këtë institucion dhe me qëllimin e mirë të organizimit të punës, në zbatim të ligjit, kam nxjerrë rregulloren ku kam detajuar detyrën që kishte secili punonjës duke ua bërë me dije më tej kundrejt marrjes dijeni për secilin punonjës. Ndërkohë kam nxjerrë urdhrat përkatës për të gjithë punonjësit përgjegjës të cilët administronin vlerat monetare për shpërndarjen e tyre tek pensionistët dhe përfituesit e ndihmës ekonomike sipas ligjit, pasi në akt-kontrollet e mëparshme ishin konstatuar shkelje të këtij

karakteri ku këto vlera monetare nuk tërhiqeshin nga përfituesit, por nga persona të tretë apo nga vetë shpërndarësit, ç'ka u bë dhe problem mediatik, por jo vetëm edhe penal....

Nga ana ime, sapo jam emëruar në detyrë, kam ngritur me urdhrat përkatës grupet e kontrollit financiar për të tre degët në varësi të Filialit Mat, me qëllim jo vetëm zbatimin e detyrave të lëna nga Akt - kontrollit e Auditit të Drejtorisë së Përgjithshme të Postës, por me qëllimin e mirë që situata të vihej nën kontroll për mbarëvajtjen normale të punës dhe eliminimin e çdo abuziviteti.

Pas mirë organizimit dhe konkretisht pas 4 muajsh punë, puna dhe përmirësimi i saj në këtë Filial dha rezultatet e dukshme....

Me fillimin e punës në Filialin e Postës Mat, më është kërkuar nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme Tiranë në zbatim të urdhrit nr. 26, dt. 31.01.2022, për plotësimin e formularit të AKSIK për paisjen me “Certifikatën e Sigurimit të Personelit” për njohje me informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”, e cila është plotësuar nga ana ime në mënyrë korrekte.

Dua t'u sqaroj se në zbatim të ligjit nr. 10296, dt. 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”,... nga ana ime që në fillim të vitit janë nxjerrë Urdhrat për krijimin e dy Komisioneve përkatës;

1- Komisioni për blerjet e vogla.

2- Komisioni për marrjen në dorëzim me procesverbal të mallit të hyrë në Filialin e Postës Mat.

Komisioni i dytë nuk ishte ngritur dhe nuk funksiononte në Filial, dhe mendoj unë që kjo është dhe zanafilla e problematikës që u krijua midis meje dhe Drejtorisë së Përgjithshme Tiranë.

Për funksionimin normal të punës në Filial, të gjitha furnizimet me bazë materiale si: Letër format A4, format traktor A4, A5, bojra printeri, kancelari të ndryshme, etj., ishin detyrim i Drejtorisë së Përgjithshme për të na furnizuar me këtë bazë materiale, e cila tenderohej nga ana e tyre dhe më pas shpërndahej nëpër destinacionet dhe aty ku kishte nevojë në Filiale.

Fillimisht me fillimin e punës time, lindte si nevojë e domosdoshme furnizimi nga ana e Magazinës qendrore në Drejtori të Përgjithshme me “Letër format A4 dhe Leter format (Traktor) A4, ose A5”, e cila përdorej çdo muaj për printimin e mandateve të pagesave të “Pensioneve” dhe “Ndhmës ekonomike”, si dokument zyrtar i rëndësishëm, për vetë Postën, Sigurimet Shoqërore dhe Bashkitë por edhe vetë përfituesit e vlerave monetare (pensionistët dhe personat e skemës së ndihmës ekonomike), pra ishte mall konsumi që shpenzohej çdo ditë (pasi ne si Filial kishim rreth 20.000 pensionistë që merrnin pensionet pranë sporteleve tona si dhe ndihma ekonomike që gjeneronin 4 Bashkitë e Qarkut Dibër).

Në fillimet e punës time, kjo bazë materiale nuk disponohej në Magazinën qendrore dhe për të vijuar procesin e punës tonë normalisht ne si Filial, detyroheshim dhe bënim “blerje të vogla” emergjente në vlerën deri 100.000 lek, për të plotësuar nevojat bazike dhe për mirë funksionimin e punës.

Kjo situatë ka vazhduar disa muaj, deri kur nga ana e Magazinës qendrore në Drejtorinë e Përgjithshme këto materiale filluan të vinin pranë Filialit, çdo muaj pas kërkesave të vazhdueshme nga ana jonë, por me problematika dhe konkretisht:

Nuk rakordonte sasia e mallit të ardhur faktik me fletë-daljet shoqëruese të mallit nga Magazina qendrore.

Komisioni i ngritur nga ana ime për marrjen në dorëzim të mallit, ma ka bërë me dije këtë problematikë dhe unë u kam kërkuar atyre që këtë situatë ta dokumentojnë në proces-verbalet përkatëse.

Këtë situatë ia kam bërë me dije personave përgjegjës në Drejtorinë e Përgjithshme, të cilët i kanë plotësuar mangësitë.

Kjo situatë ka vijuar edhe në disa raste të tjera, por duke qenë se ne nuk i lejonim këto parregullsi sepse përbënin abuzim me detyrën, ata janë detyruar dhe i kanë plotësuar këto.

Me gjithë kërkesat tona, duke qenë se ne nuk pranuan të marrim bazën materiale me mungesa, Magazina qendrore nuk na u përgjigj më me furnizime, ç'ka përbënte pengesë në vijimin e punës tonë normalisht, dhe ne ishim të detyruar të bënim “blerje të vogla emergjente” ç'do muaj.

Dua të sqaroj çfarë është më kryesorja që në blerjet e vogla që ne bënim, bie në sy dhe diferenca e vlerës së blerjes së “letrës traktor” me vlerën e furnizimit që vinte nga Drejtoria e Përgjithshme. P.sh. po të shihet fatura me nr. 604/2023, dt. 12.12.2023 e blerjes nga ana jonë ajo ka vlerën prej 2.33 lekë, ndërsa referuar faturës së furnizimit nga ana e Magazinës qendrore ka vlerën prej 3.30 lekë. Pra, duket qartë arsyeja dhe problematika e refuzimit dhe ankesës tonë.

Më pas duke qenë se në emër dhe në adresën time nuk mund të gjendej nga Shoqëria Posta Shqiptare asnjë problematikë më e vogël, nga ana e drejtuesve të Postës Shqiptare Tiranë, është gjetur problematika e “Certifikatës së Sigurisë së Personelit” (CSP).

Dua t'ju sqaroj se sikurse thashë më lart, kriterin për pajisjen me CSP, nuk e kërkon VKM-ja nr. 502, dt. 23.06.2010 “Për miratimin e rregullores “Për transportin fizik të informacionit të klasifikuar Sekret shtetëror”, sepse realisht vendi i punës si Drejtor Filiali nuk ka asnjë lidhje me informacionin e klasifikuar, por ky kriter është vendosur me qëllimin e vetëm që drejtuesit e Filialeve t'i binden hierarkisë jo me ligj, por në forma të tërthorta si në rastin tim, duke vendosur këta kriter të cilat nuk i ka normuar as Ligji, as Kodi i Punës, dhe as Kontrata e punës, por vetëm një “Urdhër”, e konkretisht Urdhri nr. 07, dt. 11.01.2023 i Administratorit të Shoqërisë, i cili së bashku me Bordin Drejtues tejkalon çdo kompetencë duke vendosur këtë kriter në lidhje me drejtuesit e Filialeve, të cilën nuk e kërkon ligji, por ky është një kriter i vendosur nga ana e tyre, me qëllim abuzivitetin dhe arritjen e synimeve të paligjshme.

Duke qenë se Drejtuesi i Institucionit të Postës Shqiptare Tiranë, është i vetmi individ që mund të ezauronte ankimin, referuar nenit 27/2 të VKM-së nr. 188, dt. 04.03.2015 “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit”, e nga ana tjetër duke qenë se, tej ligjit e ka vendosur vetë këtë kriter, pajisjen e Drejtorëve të Filialit me CSP, nuk di se përse nuk ka i ka kërkuar Agjencisë Kombëtare të Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (AKSIK), të bëjë rishqyrtimin e vendimit të marrë prej tyre, pasi vetëm titullari i institucionit legjitimohej, por është marë masa e largimit tim nga detyra, dhe unë dyshoj sepse përgjigja për pajisjen me CSP konformë ligjit duhej të vinte për një periudhë prej 120 ditëve, dhe nuk di pse Titullari im nuk ka kërkuar nga AKSIK pajisjen me këtë “Certifikatë” brenda afatit ligjor, dhe unë të mos vijoja marrëdhënien e punës për rreth

I vit e gjysmë. Si ka mundësi që në momentin që ne

nuk pranuan mallrat me diferenca për problematikat sa më sipër, CSP erdhi “negative”. Kjo tregon se ky kriter në dukje i paanshëm dhe i pa rëndësishëm të vendos në një diskriminim të tërthortë në lidhje me pozicionin e punës, ndërkohë që është i pa nevojshëm, pasi pozicioni ku unë isha, nuk kishte lidhje me informacion të klasifikuar, dhe ne vetë si institucion i Postës nuk prodhojmë dokumenta të klasifikuara.

Jo pa qëllim ligjvënësi nuk e ka normuar këtë pozicion pune të kësaj shoqërie, me pajisjen me CSP...

Dua t’ju bëj me dije sikurse kam shprehur dhe në ankesë time, jam në të gjitha drejtimet më shumë korrekt dhe i pastër se duhet, dhe do të jem i tillë si në punë ashtu edhe pa punë, nuk do të bëhem pjesë e abuzivitetit dhe jetoj me nder.

Nëse do ta kisha ndierë veten me probleme, krejt lehtësisht do të kisha dhënë dorëheqjen. Unë nuk mund të hesht përballë kësaj fyerje, shqetësimi, cënim dinjiteti dhe personaliteti, krijimit të këtij mjedisi përçmues e poshtërues për mua, pasi unë tani jam person i dyshuar dhe i padëshiruar në komunitetin ku unë jetoj.

Drejtorisë së Përgjithshme të Postës Tiranë, më dt. 17.04.2024 i është kërkuar dhënia e informacionit rreth performancës time të punës për periudhën e punësimit, por nga ana e tyre nuk na është kthyer asnjë përgjigje...

Dua t’ju bëj me dije se i jam drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me kërkesën: Me objekt: “Anullimin dhe Shfuqizimin e aktit administrativ të Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar me të cilin është vendosur “Refuzim i pajisjes me CSP për L. I. P.” me detyrën Drejtor i Filialit të Postës Mat, komunikuar me shkresën me nr. 196 prot. dt. 15.01.2024, si akt i nxjerrë në kundërshtim me ligjin”.

Me palë të Paditur: Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar.

Me palë të Tretë: Posta Shqiptare Sha., Tiranë.

Unë nuk kam ngritur padi në lidhje me mardhënien e punës, pasi nuk është rëndësia dhe problemi im ai. Problemi im është diskriminimi dhe diskretitimi që ka ndodhur me personin tim.”.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur

të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktimi e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në *“shkakun e mbrojtur”*. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: *“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjllota për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë”²*

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, ndërkohë që Protokolli 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me *“gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji”* dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se *“diskriminimi”* do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet. Sipas GJEDNJ, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu

² Shih vendimet nr.39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese.

cënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve objektivisht e ndryshme.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e *dallimit*, *kufizimit*, *përbashkimit ose preferencës* dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

Në informacionin e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, është përcaktuar si shkak diskriminimi “çdo shkak tjetër”. Subjekti ankues në rastin në fjalë nuk ka paraqitur asnjë dokument apo provë, për të vërtetuar se diskriminimi i pretenduar ka ndodhur si pasojë e ndonjë karakteristike individuale specifike.

Dokumentimi i tyre është thelbësor në çështjen e provimit të “shkakut” për të cilin subjekti ankues pretendon se si pasojë e posedimit të tij i kanë ardhur më pas të gjitha pasojat e pretenduara. Në rastin e mosprovimit e mosdokumentimit të “shkakut”, nuk mund të dilet në përfundimin se paligjshmëritë e pretenduara nga subjekti ankues lidhen pikërisht me këto “shkaqe”.

Në këtë kontekst, Komisioneri për të vlerësuar nëse pretendimet e subjektit ankues për trajtim të pabarabartë apo të padrejtë e të pafavorshëm nga ana e Shoqërisë Posta Shqiptare sh.a., lidhur me zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, vijnë për shkakun e pretenduar, duhet që fillimisht ky shkak të jetë provuar e dokumentuar para KMD-së, si shkak i njohur e parashikuar nga LMD-ja.

LMD, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë të hapur shkaqesh³. Në nenin 1, ligji liston një sërë shkaqesh për të cilat garantohet mbrojtja nga diskriminimi, por mbyllet me përcaktimin se ligji merr në mbrojtje edhe shkaqe të tjera që nuk janë listuar në nenin 1.

Neni 1, i këtij Ligji është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë të hapur shkaqesh⁴.

³ Neni 1, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 ‘Për Mbrojtjen nga Diskriminimi’, i ndryshuar citon se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje meose me çdo shkak tjetër.”

⁴ Neni 14, I KEDNJ-së: “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”.

Në mungesë të një praktike kombëtare, Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar statuse të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14, i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “*me çdo shkak tjetër*”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: “*Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive*”.

Diskriminimi⁵ karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të tij që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”, të cilën ankuesi nuk arriti ta provonte e dokumentonte se e posedon atë.

Duke mbajtur në konsideratë standardet dhe parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioneri vlerëson se, ankuesi ka ngritur pretendime për trajtim të padrejtë e të pafavorshëm nga ana e subjektit kundër të cilit ka paraqitur ankesën pranë KMD-së, Shoqërisë Posta Shqiptare sh.a., duke cituar se diskriminohet për “çdo shkak tjetër”.

Së pari, sa i takon pretendimit të ankuesit për diskriminim për “çdo shkak tjetër”, i pa dokumentuar dhe i paprovuar, Komisioneri vlerëson se nuk qëndron, pasi ai nuk është “shkaku” në vetvete. Për rrjedhojë duhet shpjeguar, provuar e faktuar prej tij se e mbart atë.

Së dyti, lidhur me shpjegimin e ankuesit se tek ky shkak, ai referon faktin se largimi i tij nga puna ka qenë i paramenduar, *për arsyen se ai ka ngritur grupet e kontrollit financiar për të tre*

⁵ “Diskriminimi” përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

degët në varësi të Filialit Mat, me qëllim mbarëvajtjen normale të punës dhe eliminimin e çdo abuziviteti, si dhe për arsye të refuzimit apo mos pajisjes me certifikatë sigurie, i cili nuk është një parashikim ligjor për ushtrimin e detyrës së Drejtuesit të Filialit të Postës Mat, Komisioneri vlerëson se, nuk plotëson elementët e nevojshëm të kërkuar për përcaktimin e justifikimit e “shkakut” sipas LMD-së.

Në kuptim të LMD-së, *“Shkak i mbrojtur është një karakteristikë e identifikueshme, objektive apo personale, ose “status”, nga të cilat individët ose grupet e individëve janë të dallueshëm nga njëri-tjetri.⁶”*

Lidhur me sa më lart, Komisioneri vëren se, arsyetimi i përdorur nga ankuesi lidhur me faktin se *largimi i tij nga puna ka qenë i paramenduar, pasi ai ka ngritur grupet e kontrollit financiar për të tre degët në varësi të Filialit Mat, me qëllim mbarëvajtjen normale të punës dhe eliminimin e çdo abuziviteti, si dhe për arsye të refuzimit apo mos pajisjes me certifikatë sigurie, i cili nuk është një parashikim ligjor për ushtrimin e detyrës së Drejtuesit të Filialit të Postës Mat, nuk lidhen me cilësitë e karakteristikat e identifikueshme të ankuesit në kontekst të shkakut të mbrojtur sipas LMD-së.*

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pretendimi i ankuesit për diskriminim për “çdo shkak tjetër”, sipas kuptimit të LMD-së, nuk rezultoi i provuar bazuar në provat e depozituara prej tij.

Pala ankuese nuk parashtron e argumenton bindshëm me fakte e prova, se mbart shkakun e pretenduar, mbi të cilin të mund të vijohej me hetimin e ankesës, nëse ai është trajtuar në mënyrë të padrejtë apo të diferencuar nga ana e Shoqërisë Posta Shqiptare sh.a., krahasuar me persona të tjerë të cilët ndodhen në të njëjtat kushte me to, trajtim i cili të jetë motivuar pikërisht nga “çdo shak tjetër”, i provuar prej tij.

Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese.

Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/ç, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, i cili citon se: *“4. Ankesa nuk pranohet nëse:ç)nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”*, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE:

⁶ <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç, të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues L. P., pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Çdo shkak tjetër)

(Fusha: Punësim)